

Në bazë të nenit 13.paragrafi 1. pika 1. Të Statutit të Partisë Demokratike Shqiptare, në propozim të Këshillit Qëndror të PDSH-së në mbledhjen e mbajtur më date 11.10.2020. Kuvendi VII-të, i rregullt zgjedhorë i PDSH-së në mbledhjen e mbajtur më 11.10.2020 miraton këtë:

STATUTI

I

PARTISË DEMOKRATIKE SHQIPTARE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Partia Demokratike Shqiptare është subjekt politik i qytetarëve të lirë, e cila aktivitetin e vet e zhvillon në bazë të Programit, Statutit dhe dokumenteve të miratuara në Kuvend.

Me Statut, si dhe me aktet e tij më të larta, rregullohen simbolet publike dhe selia e Partisë Demokratike Shqiptare, anëtarësimi dhe ndërprerja e anëtarësisë, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë të anëtarëve, grumbullimi dhe disponimi me mjete, sjellja e akteve dhe ndërprerja e veprimtarisë së Partisë Demokratike Shqiptare.

Me këtë Statut Partia Demokratike Shqiptare (në tekstin vijues:PDSH), vërteton emërtimin dhe selinë e PDSH-së, simboleve dhe identitetin vizuel, pamjen dhe përmbajtjen e vulës së PDSH-së dhe njësitë organizative sipas principeve teritoriale, qëllimet programore, kushtet dhe mënyrën dhe ndërprerjen e anëtarësimit, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e anëtarëve, organizimin e brendshëm sipas principeve teritoriale, organet, autorizimet e sajë, përbërjen, mënyrën e zgjedhjes dhe shkarkimit, kohëzgjatjen e mandateve dhe mënyrën e vendim-marrjes, përfaqësimin e PDSH-së, procedurën për ndryshime dhe plotësime të Programit, Statutit dhe procedurën e ndryshimit të akteve tjera të përgjithshme të PDSH-së, realizimin e veprimtarisë publike, mënyrën e vendimit për bashkpunimin e PDSH-se me të gjitha partitë tjera në vend dhe jashtë vendit, bashkimin e subjekteve politike, mënyrën e finansimit të PDSH-së, mënyrën e udhëheqjes së kontrollës së brendshme financiare, personin përgjegjës për punët financiare, sjelljen e raportit dhe udhëheqjen e librit të PDSH-së, personin e autorizuar për kontaktim me organet kompetente, mënyrën e sjelljes së vendimeve për ndërprerjen e veprimtarisë, mënyrën e disponimit të pasurisë së PDSH-së në rast të ndërprerjes së veprimtarisë së sajë si dhe të gjitha çështjet tjera me rëndësi për punë dhe veprimtari të PDSH-së.

1.1 Emërtimi i subjektit

Neni 2

Emërtimi i subjektit është: Partia Demokratike Shqiptare (në tekstin e mëtejme PDSH)

PDSH është subjekt politik i pakicës nacionale e cila veprimtarinë e vet e orienton në përfaqësimin, paraqitjen dhe mbrojtjen e interesave të pakicës nacionale të shqiptarëve, avansimin e të drejtave në bazë të Kushtetutës, Ligjit dhe standardeve ndërkombëtare.

Emërtimi i shkurtuar i subjektit është “ PDSH “ ,në gjuhën serbe “ DPA”.

1.2 Selia Qëndrore

Neni

Selia e subjektit është në Preshevë, Republikën e Serbisë, rruga Mare Llonçar p.n. PDSH vepron në mënyrë të pavarur në territorin e Republikës së Serbisë: Preshevë, Bujanocë, Medvegjë e më gjërë. PDSH vepron dhe organizohet edhe në botën e jashtme.

1.3 Simboli dhe Vula

Neni 4

PDSH ka vulën, simbolin dhe llogarinë e vet, vula ka formën rrethore kurse në përmbajtjen e brendshme të saj është “Partia Demokratike Shqiptare” në gjuhën serbe “Demokratska Partija Albanaca”, diametri i vulës është 40 mm, formën dhe përmbajtjen e vulës dhe të simbolit e përcakton kryesia e subjektit.

1.4 Veprimtaria publike

Neni 5

Puna dhe veprimi i PDSH-së është publike.

Për punën e saj PDSH njofton anëtarësin dhe opinionin.

Anëtarësia njoftohet përmes informimit publik, intern, informatës, propozimeve si dhe nëpërmjet takimeve dhe diskutimeve.

Opinionin njoftohet për punën e PDSH-së përmes mjeteve të informimit publik, informatave, konferencave për gazetarë, lajmërimeve, publikimeve të veçanta dhe periodike etj.

Përgjashtimisht, nga puna e Këshillit Qendror të PDSH-së mund të largohet publiku, e cila rregullohet me vendime të posaçme.

Vendimin për largimin e publikut e sjell Këshilli Qendror dhe Kryetari i PDSH-së.

Për pjesëmarrjen e publikut në seancë të organeve tjera të subjektit vendoset në vet seancë.

II. ANËTARËSIMI

Kushte dhe kritere të antarësisë

Neni 6

Anëtarë i PDSH –së mundë të bëhet qytetari i moshës madhore, i cili e përkrah programin dhe statutin e Partisë.

Anëtarësimi dhe dalja nga PDSH-ja bëhet në baza vullnetare.

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të PDSH-së janë:

- 1) të zgjedh dhe të zgjidhet në të gjitha organet e subjektit;
- 2) në mënyrë të barabartë të marrë pjesë në aktivitetin e subjektit;
- 3) të ngrisë iniciativa dhe të japë propozime;
- 4) të ruajë autoritetin dhe interesat e subjektit;
- 5) t'i përhapë dhe t'i propagandojë përcaktimet programore dhe qëndrimet politike të subjektit;
- 6) ta respektojë statutin dhe vendimet e organeve të subjektit;
- 7) të angazhohet në fushatëzgjedhore për suksesin e partisë në zgjedhje;
- 8) të paguaj anëtarësinë.

1.1.Përfundimi, ndërprerja dhe zëvendësimi i anëtarisë

Neni 7

Ndërprerja e anëtarisë në subjekt bëhet me vetëlargim nga evidenca ose përjashtim nga subjekti dhe në raste vdekjes së anëtarit.

Përjashtimi nga PDSH bëhet për shkak të shkeljes së rendit dhe obligimeve nga neni 6. i Statutit.

Përjashtimin nga anëtarësia e bëjnë kryesitë e degëve në bazë të fakteve dhe provave të grumbulluara.

Zëvendësimi i anëtarëve të rinjë të Këshillit Qëndror dhe të anëtarëve të kryesisë nga paragrafi 1.dhe 2. të këtij neni bëhet sipas rënditjes në listën pritëse të kandidatit me numër më të madh të votave të fituara në Kuvendin e fundit zgjedhor.

Ankesën e vendimit për përjashtim e shqyrton Kryesia e Partisë.

Vendimi i Kryesisë së PDSH-së është përfundimtarë.

Ankesa në vendimin për largim nga subjekti bëhet në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së vendimit nga Këshilli Qendror i subjektit i cili vendos në ankesë në afat prej 15 ditësh nga pranimi i ankesës.

Vendimi i Këshillit Qendror të subjektit është i plotfuqishëm.

Neni 8

Anëtarët e subjektit, të cilët nuk pajtohen me vendimin e shumicës, kanë të drejtë që edhe më tutje ta mbajnë dhe mbrojnë mendimin e tyre në kuadër të organit të subjektit, por duhet të i respektojnë vendimet e subjektit.

Neni 9

Anëtari i subjektit nuk mund të merret në përgjegjësi për shkak të prezentimit të mendimit të kundërt në kuadër të organit të subjektit.

Anëtari i subjektit përgjigjet personalisht për eksponimin e tijë publikë, nëse eksponimi i tijë është në kundërshtim me përcaktimet programore të PDSH-së.

III.ORGANET DHE ORGANIZIMI I PARTISË

Neni 10

Organet e partisë janë:

- 1) Kuvendi;
- 2) Kryetari;
- 3) Këshilli Qendror;
- 4) Kryesia;
- 5) Komisioni Statutar.
- 6)

IV.KUVENDI

Neni 11

Organi më i lartë i Partisë është Kuvendi i subjektit.

Kuvendin e subjektit e përbëjnë delegatët e Kuvendit të cilët delegohen nga degët, nëndegët, aktivet dhe forumet si dhe anëtarët sipas funksionit.

Neni 12

Delegat të Kuvendit sipas funksionit janë anëtarët e Kryesisë së subjektit, këshilltarët komunal dhe deputetët, dhe anëtarët e Kuvendit të Këshillit Kombëtarë Shqiptar.

Nëndegët e Partisë delegojnë në Kuvend nga tre (3) delegat për vendvotim, gjithashtu mundë të propozojnë edhe nga një (1) delegat më tepër nga gjinia më pak e përfaqësuar e që njëkohsishtë do të jetë në listën e veçantë për Këshill Qëndror, aktivet nga një (1) delegat, ndërsa forumi i gruas dhe ai rinor nga katër (4) delegat plus kryetari i forumit.

Nga propozimet e nëndegëve, formohet listë e gjinisë më pak të përfaqësuar në organet e partisë dhe bashkërisht gjysma e tyre zgjidhet për anëtare të Këshillit Qendrorë të partisë.

Listat e delegatëve nga ky nen dorëzohen së paku 15 dit para Kuvendit komisionit për zgjedhje brenda subjektit.

Neni 13

Kompetencat e Kuvendit janë:

- 1) miraton Programin dhe Statutin e subjektit si dhe ndryshimet e plotësimet e tyre;
- 2) shqyrton dhe miraton raportin mbi punën e Partisë mes dy kuvendeve;
- 3) zgjedh anëtarët e Këshillit Qendror të subjektit;
- 4) zgjedh dhe shkarkon kryetarin e subjektit;
- 5) nxjerrë rezoluta, deklarata dhe merr vendime;
- 6) përcakton orjentimet themelore të veprimit politik të subjektit;
- 7) kryen edhe punë tjera në pajtim me Programin dhe Statutin e subjektit;
- 8) në propozim të delegatit, Kuvendi ka të drejtë të shpall anëtarë, kryetarë nderi të PDSH-së;
- 9) me propozim të delegatëve, Kuvendi ka të drejtë që ta shpallë personalitetin ose kryetarin e nderit.
- 10) për anëtarë, kryetarë të nderit, mund të shpallet aktivisti, ish-kryetari ose personaliteti i shquar, për shkak të shërbimeve të interesit të përgjithshëm.

Në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, kur Kuvendi nuk mundë të tubohet, kompetencat e tijë i merr KQ i Partisë, përkatësisht Kryesia e subjektit.

Neni 14

Kuvendi i subjektit mbledhet një herë në katër (4) vjet .

Kuvendi i subjektit konvokohet edhe atëher kur këtë e kërkon një e treta (1/3) delegatëve të Kuvendit.

Kuvendin e subjektit e konvokon kryetari i subjektit, kryesia e subjektit ose një e treta (1/3) e anëtarëve tëKQ tësubjektit.

Punën e Kuvendit të subjektite drejton kryetari i subjektit.

Sipas nevojës mundë të konvokohet edhe Kuvendi i jashtëzakonshëm.

Neni 15

Vendimet e Kuvendit dhe të KQ të subjektit janë të plotëfuqishme nëse në punën e organeve përkatëse marin pjesë më tepër se gjysma e anëtarëve që e përbëjnë organin dhe nëse për to votojnë shumica e të pranishmëve.

Për zgjedhjen e kryetarit dhe Këshillit Qendror të subjektit votimi bëhet me vota të fshehta nëse organi nuk vendos ndryshe.

Vendimet në Kuvend merren me vota të hapta nëse organi nuk vendos ndryshe.

V.KËSHILLI QENDROR

Neni 16

KQ është organi më i lartë i Partisë në mes dy kuvendeve.

KQ i Partisë numron prej 35 deri 69 anëtarë.

KQ i Partisë zgjedhet me votim të fshehtë nga delegatët e Kuvendit, nëse Kuvendi nuk vendosë ndryshe.

Neni 17

Anëtarët e Këshillit Qendror të PDSH-së zgjidhen nga delegatët e Kuvendit të partisë duke marrë parasyshë përfaqësimin gjithpërfshirës në bazë të listave të propozuara nga degët, nëndegët, forumet dhe aktivet.

Neni 18

Delegatët sipas funksioneve (neni 12 i këtij statuti), radhiten në listat, sipas venbanimeve prej nga përfaqësohen.

Neni 19

Propozuesit e listave të delegatëve propozojnë anëtarët e Këshillit Qendror.

Nga lista e delegatëve të propozuesit për anëtar të Këshillit Qendror propozohet numri i përafërt i fituar si vlerë e herësit të numrit të delegatëve në listë nda për tre (3) plus një anëtar më tepër i cili gjithashtu të jetë nga lista e delegatëve të propozuesit.

Neni 20

Delegatët e Kuvendit votojnë secilën listë të propozuesëve, nga secila listë votohet një më pak se numri i propozuar nga propozuesi.

Fletëvotimi është i pavlefshëm nëse nuk votohet në përputhje me alinenë një (1) të këtij neni.

Listat përpilohen në bazë të alfabetit sipas emrit të delegatit.

Në rastë se kandidatët brenda listës kanë numër të njejtë të votave, atëherë zgjedhet ai i cili është i radhitur më lartë në listë sipas rendidjes alfabetike.

Neni 21

Numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit Qendror konstatohet në Kuvendin e partisë pas votimit.

Neni 22

Këshilli Qendror mbledhet më së voni 15 ditë pas mbajtjes së Kuvendit.

Neni 23

Këshillin Qendror të Degës së Preshevës e përbëjnë anëtarët e KQ të PDSH-së nga territori i Komunës së Preshevës.

Neni 24

Mbledhjen e Këshillit Qendror e konvokon Kryetari, Kryesia e Partisë si dhe nëse këtë e kërkojnë 1/3 e anëtarëve të KQ.

Mbledhja e Këshillit Qendrorë konvokohet sipas nevojës ose së paku një herë në vit, e sidomos para dhe pas zgjedhjeve të çfarëdo niveli.

Neni 25

Këshilli Qendror :

- 1) propozon projekt programin dhe statutin e subjektit;
- 2) përcakton qëndrimet dhe orientimet kryesore politike të subjektit dhe të organeve të sajë;
- 3) kujdeset për realizimin e vendimeve të subjektit;
- 4) zgjedh anëtarët e kryesisë;
- 5) zgjedh komisionin statutar;
- 6) merr vendim për shpalljen e zgjedhjeve në kuadër të subjektit;
- 7) shqyrton dhe miraton raportin mbi punën e subjektit ndërmjet dy kuvendeve.
- 8) kryen edhe punë të tjera që ia beson Kuvendi i subjektit,
- 9) miraton propozimlistën e kandidatve të subjektit në organet dhe institucionet komunale e shtetërore

VI.KRYESIA

Neni 26

Kryesia është organ politik i subjektit.

Kryesia e përgjithshme e Partisë, dega në Preshevë numëron 18 anëtarë dhe kryetari, prej të cilëve 30% nga gjinia më pak e përfaqësuar.

Kryesia e subjektit përbëhet prej 19 anëtarësh nëse Këshilli Qendror i subjektit nuk vendosë ndryshe.

Neni 27

Kryesinë e subjektit e zgjedhë Këshilli Qendror i subjektit.

Zgjedhja e anëtarve të Kryesisë bëhet me vota të fshehta nga anëtarët e Këshillit Qendror të subjektit.

Kryesia zgjedhet në atë mënyrë ku përcaktohet lista e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit Qendror.

Anëtarët e Këshillit Qendror zgjedhen në atë mënyrë ku çdo anëtar i Këshillit Qendror rrethon 18 emra nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit Qendror të cilët janë të propozuar në listë.

Në rastin kur më shumë se një kandidat ka numër të njëjtë të votave atëherë në mes të kandidatëve me numër të njëjtë të votave zgjedhet kandidati sipas radhitjes alfabetike” Emrit të Kandidatit”.

Neni 28

Kryesisa e përgjithshme e PDSH-së zgjedhet në mbledhjen e parë të Këshillit Qendror, më së voni 15 ditë pas mbajtjes së Kuvendit.

Neni 29

Kryesia zgjedhet në atë mënyrë ashtu që formohet lista e anëtarëve të Këshillit Qendror sipas radhitjes alfabetike, duke marrë parasyshë listën e anëtarëve të Këshillit Qendror të degëve të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. Anëtarët e Këshillit Qendrorë të secilës degë votojnë listën e tyre. Të gjithë anëtarët kanë të drejtë të votojnë dhe të jenë të votuar.

Neni 30

Në listën e Degës së Komunës së Preshevës votohen katërbëdhjetë (14) anëtarë gjersa në listën e degës së Bujanocit dhe Medvegjës votohen katër (4), gjegjësisht 2(dy) anëtar.

Neni 31

Fletëvotimi është i vlefshëm nëse janë të votuar katërbëdhjetë (14) anëtar në listën e degës së Preshevës e katër (4) anëtar në listën e degës së Bujanocit dhe (2) dy anëtar në listën e degës së Medvegjës, në secilin rast tjetër fletëvotimi konsiderohet i pavlefshëm. Nëse dy e më tepër kandidat për anëtar kryesie kanë numër të barabartë të votave, votimi përsëritet derisa të zgjedhet njëri prej tyre.

Neni 32

Kryesinë e degës së Preshevës e përbëjnë anëtarët e kryesisë së përgjithshme të partisë nga Komuna e Preshevës.

Neni 33

Mandati i anëtarëve të Kryesisë zgjatë 4(katër) vite. Anëtarët e Kryesisë nga neni 27 alinea një (1) mund të revokohen edhe para skadimit të mandatit në rastet kur këtë do ta vlerësoj organi i cili i ka zgjedhur. Anëtarët e Kryesisë mundë të japin dorëheqje para skadimit të mandatit, por janë të obliguar të japin arsyetim me shkrim për dorëheqjen e tyre.

Neni 34

Me propozim të Kryesisë KQ bënë kooptimin e anëtarëve të rinjë të Kryesisë të cilët mund të mos jenë anëtarë të organeve të deriatëhershme të Partisë.

Neni 35

Kryesia me vota të fsheta zgjedh nënkryetarët dhe sekretarin e përgjithëshëm të partisë. Zgjedh dhe emron komisionet, këshillat dhe trupat tjerë punues dhe ua përcakton detyrat konkrete.

Propozon listën e kandidatve të Partisë në organet dhe institucionet komunale e shtetërore.

Propozon komisionin satutar.

Zgjedh organin mbikqyrës të subjektit.

Cakton përbërjen e delegacioneve të Partisë për takime dhe punën me subjektet e mbrendshme dhe ndërkombëtare .

Udhëheqë politikën kadrovike në Parti.

Kujdeset për realizimin e përcaktimeve programore dhe statutare të Partisë;

Zbaton vendimet e Këshillit Qendror të Partisë.

Shqyrton çështjet aktuale nga jeta politike, ekonomike, sociale, arsimore dhe shtetërore në aspektin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Vlerëson aktivitetin e degëve dhe nëndegëve lidhur me angazhimin e tyre për realizimin e përcaktimeve programore dhe zbatimin e vendimeve të organeve të Partisë.

U jep udhëzime degëve dhe nëndegëve për realizimin parimor të politikës së Partisë dhe vendosë për shmangien e dukurive negative në punën e tyre.

Vendosë për bashkëpunim me partitë tjera politike, asociacionet dhe shoqatat e ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

Përcjell punën e deputetëve, këshilltarëve dhe funksionarve të tjerë nga Partia, u jep udhëzime, sugjerime dhe ndihma në punën e tyre, aty ku janë të angazhuar.

Shqyrton dhe miraton planin financiar dhe llogarin përfundimtare të Partisë.

Cakton lartësin e anëtarisë.

Propozon shpalljen e zgjedhjeve në kuadër të Partisë.

Kryen edhe punë të tjera në kuadër të kompetencave të sajë.

Mbledhjet e kryesisë së Partisë thirren së paku një herë në muaj.

VII. KRYETARI I PARTISË

Neni 36

Kandidat për kryetar të PDSH-së mundë të jet çdo anëtarë i partisë i cili grumbullon së paku 30 nënshkrime nga delegatët e përbërjes së re të kuvendit të PDSH-së.

Lista me nënshkrime të kandidatit i dorëzohet komisionit zgjedhor në kuadër të Partisë të cilin e zgjedh KQ i partisë, së paku shtatë(7) ditë para mbajtjes së Kuvendit zgjedhor të Partisë.

Neni 37

Në rastë se në raundin e parë të votimeve kemi më tepër se dy kandidat, zgjidhet kandidati i cili ka marrë shumicën nga numri i përgjithshëm i delegatëve.

Nëse asnjëri nga kandidatët nuk e ka marrë numrin e mjaftueshëm për tu zgjedhur, në raundin e dytë kandidohen dy prej tyre që kanë arritë numrin më të madh të votave.

Për kryetar zgjidhet kandidati i cili ka fituar numrin më të madhë të votave të atyre që kanë votuar.

Neni 38.

Kryetari i Partisë:

- 1) Kryetari i Partisë e përfaqëson dhe prezanton Partinë;
- 2) Harmonizon dhe mbikqyrë funksionimin e Partisë;
- 3) Konvokon mbledhjet e kryesis dhe udhëheq me to ;
- 4) Kryeson me punën e Kuvendit dhe KQ të Partisë;
- 5) Jep raport për punën e Kuvendit, KQ dhe të Kryesisë së partisë;
- 6) Bën angazhimin e anëtarëve të Kryesisë për punë të ndryshme në Parti;
- 7) Zbaton planin financiar dhe u jep llogari për të hyrat dhe të dalat në Parti organeve partiake;
- 8) Nënshkruan të gjitha aktet të miratuara nga organet e Partisë;
- 9) Propozon anëtarët e këshillit mbikqyrës
- 10) Për punën e vet Kryetari i Partisë i përgjigjet Kryesisë, Këshillit Qendror dhe Kuvendit të Partisë;

Neni 39

Kryetari i PDSH-së është njëkohësisht edhe kryetar i degës ku edhe e ka venbanimin.

VIII. NËNKRYETARËT E PARTISË

Neni 40

Nënkryetarët e partisë i zgjedh Kryesia e partisë.

Njëri nga nënkryetarët e partisë duhet të jetë nga gjinia më pak e përfaqësuar në Kryesinë e përgjithshme të partisë.

Nënkryetarët për punën e vet i përgjigjen Kryetarit të Partisë, Këshillit Qendror dhe Kuvendit të Partisë.

Neni 41

Nënkryetarët e partisë e zëvendësojnë Kryetarin në mungesë, ose pengesë në kryerjen e punëve.

I ndihmojnë Kryetarit në kryerjen e punëve të tij.

I kryejnë ato punë që ua beson Kryetari i Partisë.

IX. SEKRETARI I PARTISË

Neni 42

Sekretarin e partisë e zgjedh Kryesia e partisë.

Kompetencat e Sekretarit janë:

- 1) udhëheq me punën dhe shërbimet profesionale juridike në Parti;
- 2) i ndihmon Kryetarit për harmonizimin e punëve në Parti ;
- 3) organizon zbatimin e vendimeve të organeve të Partisë;
- 4) organizon dhe kujdeset për administratën e Partisë;
- 5) kryen edhe punë të tjera të parapara me statut.
- 6) mban proceset nga mbledhjet e organeve të Partisë.
- 7) e përcjell zbatimin e qëndrimeve, vendimeve dhe konkluzioneve që sjellin organet e Partisë.

Sekretari për punën e vet i përgjigjet Kryetarit, KQ dhe Kuvendit të Partisë.

X. KOMISIONI STATUTAR

Neni 43

Komisioni statutar është organ kolegial dhe i pavarur i Partisë, i cili përbëhet prej Kryetarit, zëvendësit dhe tre anëtarëve të tjerë.

Anëtarët e Këshillit Qendror dhe të Kryesisë së Partisë nuk mund të jenë anëtarë të komisionit statutar.

Anëtarët e komisionit statutar me propozim të kryesisë së subjektit i zgjedh Këshilli Qendror.

Kryetarin dhe nënkryetarin e komisionit statutar e zgjedhin anëtarët e këtij komisioni nga radhët e tij.

Anëtar i komisionit statutar mund të jetë çdo anëtar i cili ka të kryer fakultetin juridik.

Shkarkimi i anëtarëve të komisionit statutar bëhet në të njëjtën mënyrë ashtu si edhe zgjedhen.

Mandati i anëtarëve të komisionit statutar ndërpritet pas skadimit të mandatit për të cilin janë zgjedhur, me dorëheqje të anëtarit ose të të gjithë anëtarëve të komisionit statutar.

Komisioni statutar kryen këto punë:

- 1) interpreton Statutin dhe aktet e tjera normative të Partisë;
- 2) përgatit propozimndryshimet dhe plotësimet e Statutit;
- 3) kujdeset për ligjëshmërinë e vendimeve të të gjitha organeve të Partisë dhe për

harmonizimin e këtyre vendimeve me Statutin e Partisë.

XI.KËSHILLI MBIKQYRËS

Neni 44.

Këshilli mbikqyrës është organ mbikqyrës i subjektit.

Mandati i këshillit mbikqyrës është 4 (katër) vite.

Këshillin mbikqyrës e përbëjnë 3 (tre) anëtar të cilët i zgjedh dhe i shkarkon Kryesia e PDSH-së.

Këshilli mbikqyrës kontrollon të hyrat dhe mënyrën e menaxhimit të mjeteve financiare të PDSH-së.

Këshilli mbikqyrës jep llogari mbi kontrollin e brendshëm dhe kontrollin financiar, Kryesisë së subjektit.

XII. DEGËT DHE NËNDEGËT E PARTISË

Neni 45.

Partia është e organizuar sipas parimit teritorial në vend dhe jashtë dhe atë:

- 1) në degë;
- 2) nëndegë;
- 3) aktive;
- 4) forum të gruas;
- 5) dhe rinisë;
- 6) dhe forma tjera të organizimit.

Degët e Partisë organizohen në kuadër të komunës së Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, kurse nëndegët në kuadër të bashkësive lokale të komunës së Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës.

Dega e Partisë themelohet në Kuvendin themelues, i cili numron 50-100 anëtarë.

Nëndega themelohet në kuvendin themelues i cili numron më së paku 15 anëtarë.

Aktivet e partisë themelohen në vendbanime ku ka numër të vogël të anëtarëve dhe duhet të kenë së paku (7) shtatë anëtarë.

Neni 46.

Organet e degës janë:

- 1) Kuvendi;
- 2) Kryetari;
- 3) Këshilli Qendror;
- 4) Kryesia e degës.

Kuvendi i degës është organi më i lartë i degës.

1.Kuvendi i degës

Neni 47.

Kuvendin e Degës e përbëjnë delegatët të cilët delegohen nga nëndegët, forumet, aktivet dhe anëtarët tjerë sipas funksionit.

1.1 Përbërja e Kuvendit të degës

Neni 48.

Kuvendi i degës përbëhet prej 31-45 anëtarësh, të cilët i propozojnë nëndegët, aktivet, forumet dhe anëtarët sipas funksionit.

Çdo nëndegë e degës në Bujanoc dhe Medvegjënë Kuvend të Degës përfaqësohet me nga pesë (5) delegat për vendvotim.

Çdo aktiv i degës së Bujanocit dhe Medvegjës delegon nga dy (2) delegat në Kuvend të Degës.

Forumi i Gruas dhe ai Rinorë delegojnë nga pesë (5) delegat.

Sipas funksioneve anëtarë të Kuvendit të degës janë edhe anëtarët e Kryesisë së degës dhe këshilltarët komunal.

Dega e Bujanocit dhe Medvegjës delegonë në Kuvendin e Përgjithshëm të Partisë nga nëndegët e saj nga tre (3) delegatë.

1.2Kompetencat e kuvendit te degës

Neni 49.

Miraton programin e punës dhe përcakton orientimin politik të Partisë në Komunë.

Shqyrton dhe miraton raportin e punës së Kryesisë së degës.

Zgjedh anëtarët e Kryesisë, Kryetarin, nënkryetarin dhe sekretarin e Kryesisë së degës.

Përcakton programin zgjedhor dhe propozon kandidatët për këshilltarë komunal.

Neni 50.

Kuvendi i Degës mblidhet një herë në katër (4) vjet .

Kuvendi i Degës konvokohet edhe atëher kur këtë e kërkon një e treta (1/3) delegatëve të Kuvendit.

Sipas nevojës mundë të konvokohet edhe Kuvendi i jashtëzakonshëm.

Punën e Kuvendit të Degës e drejton kryetari i degës dhe kryesia e punës prej pesë (5) anëtarëve e cila zgjidhet nga kuvendi.

2.Këshilli Qendror i Degës

Neni 51.

Këshillin Qendror të Degës e zgjedh Kuvendi i Degës.

Këshilli Qendror i Degës numron nga 25 – 51 anëtarë.

Procedura e zgjedhjes së Këshillit Qëndror të Degës është e njëjtë me procedurën e zgjedhjes sëKëshillit Qëndror të Degës të Partisë.

2.1 Kompetencat e Këshillit Qëndror të Degës

Neni 52.

Këshilli Qendror i Degës:

- 1) përcakton qëndrimet dhe orientimet kryesore politike të Partisë dhe të organeve të sajë në kuadër të Degës;
- 2) kujdeset për realizimin e vendimeve të degës së Partisë;
- 3) zgjedh anëtarët e kryesisë së degës;
- 4) shqyrton dhe miraton raportin mbi punën e degësndërmjet dy kuvendeve.
- 5) kryen edhe punë të tjera që ia beson Kuvendi i degës.
- 6) miraton propozimlistën e kandidatve të degës në organet dhe institucionet komunale.

3.Kryesia e degës

Neni 53.

Kryesia e degës përbëhet prej 9-15 anëtarësh në të cilin numër bëjnë pjesë edhe kryetari, nënkryetari dhe sekretari i degës.

Kryesia e degës:

- 1) udhëheq me politikën e partisë në teritorin e Komunës;
 - 2) propozon kandidatët për këshilltarë komunal;
 - 3) formon shtabin zgjedhor;
 - 4) vendos për masat ndaj anëtarëve të Partisë;
 - 5) udhëheq me politikën kadrovike në degë;
 - 6) përcjell punën e këshilltarëve komunal, bashkëpunon me ta, u jep udhëzime, sugjerime dhe ndihma në punën e tyre në kuvendin komunal;
- Kryesia e degës mban mbledhje më së paku njëher në muaj.

3.1. Kryetari, nënkryetari dhe sekretari i degës

Neni 54.

Kryetarin e degës e zgjedh Kuvendi i Degës.

Nënkryetarin dhe Sekretarin e degës e zgjedh Kryesia e Degës.

4. Nëndega

Neni 55.

Nëndega themelohet në kuvendin konstituiv, i cili numron më së paku 15 anëtarë.

Organet e nëndegës janë:

- 1) Kuvendi;
- 2) dhe Kryesia e nëndegës.

Kuvendi i nëndegës e zgjedh kryesin e nëndegës .

Kryesia e nëndegës përbëhet prej 7 – 13 anëtarë.

Kryesia nga radhët e veta zgjedh:

- 1) Kryetarin;
- 2) Sekretarin;
- 3) dhe Arkatarin.

XIII. FORUMET E PARTISË

Neni 56.

Në kuadër të PDSH-së veprojnë:

- 1) Forumi i Gruas;
- 2) Forumi Rinisë dhe
- 3) Forume tjera të Partisë të cilët aktivitetin e tyre e realizojnë në bazë të Programit dhe Statutit të Partisë.

Forumet e Partisë në Kuvendin e Partisë përfaqësohen me nga pesë (5) delegatë.

5. Mandati, vendosja dhe zgjedhja e organeve

Neni 57.

Mandati i organeve të Partisë në të gjitha nivelet zgjatë 4 vjet.

XIV. FINANSIMI, SHFRYTËZIMI DHE DISPONIMI ME MJETET E PARTISË

Neni 58.

Për veprimtarinë e saj Partia mjetet i siguron nga anëtarësia, kontributet e personave fizikë dhe juridik si dhe nga veprimtaria ekonomike dhe botuese në pajtim me kushtet e parapara me ligj.

Shfrytëzimi, disponimi i mjeteve dhe puna financiare e Partisë bëhet përmes llogarisë.

PDSH mund të grumbullojë mjete për veprimtarinë e saj edhe nga burimet publike dhe private, në përputhje me ligjin.

Burimet publike i përbëjnë mjetet nga buxheti i Republikës së Serbisë dhe buxheti i vetadministrimit lokal, të lejuara për finansimin e punës së rregullt të subjektit politik dhe shpenzimeve për fushatë zgjedhore.

Burimet private janë: anëtarësia, donacionet e personave fizik dhe juridik, të ardhurat nga promovimi i aktiviteteve politike të subjektit dhe burimet tjera në përputhje me ligjin.

Në propozim të Kryetarit, Kryesia e PDSH-së zgjedh kontabilistin i cili autorizohet të udhëheq kontabilitetin e subjektit dhe njëkohësisht është personi i autorizuar që të kontaktoj me organet kompetente.

XV. BASHKËPUNIMI ME PARTITË DHE ASOCIACIONET TJERA

Neni 59.

Partia do të bashkëpunojë me të gjitha partitë politike dhe asociacionet tjera me orientim demokratikë e progresiv, mbrenda dhe jashtë vendit.

XVI. SHUARJA E PARTISË DHE DISPONIMI ME MJETET DHE PRONËN NË RASTË TË SHUARJES

Neni 60.

Partia do të shuhet nëse për funksionimin e sajë nuk egzistojnë kushte ligjore dhe statutare.

Vlerësimin për mosegzistimin e kushteve nga paragrafi paraparak e bënë Kuvendi i Partisë.

XVII. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 61.

Ndryshimi dhe plotësimi i Statutit bëhet sipas procedurës për nxjerrjen e tijë në Kuvend të partisë.

Propozimet për plotësimin dhe ndryshimin e statutit mundë t'ia paraqesin Kuvendit delegatët e Kuvendit dhe çdo organ i Partisë.

Neni 62.

Nëse përshkak të natyrës urgjente kërkohet ndryshimi dhe plotësimi i Statutit këtë mundë ta bëj edhe Këshilli Qëndror i Partisë.

Neni 63.

Shpjegimet për zbatimin e dispozitave të këtijë Statuti i jep sekretari i partisë si dhe komisioni statutar.

Neni 64.

Ky Statut hyn në fuqi ditën e miratimit në Këshillin Qendror të PDSH-së, të mbajtur më, 11.10.2020.

Neni 65.

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti pushon të vlejë Statuti i miratuar më, 02.02.2010.

KËSHILLI QENDROR I PDSH-së

**Në Preshevë
Më: 11.10.2020**



KQ i PDSH-së

Kryetari: Dr. Sc. Ragmi Mustafa